

UDHËZIM
Nr. 23, datë 20.9.2024

**PËR RREGULLAT, PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT, PËR
VENDOSJEN E MASAVE, PËR ÇRRËNJËSJEN DHE PARANDALIMIN E
PËRHAPJES SË KALBËZIMIT UNAZOR TË PATATES *CLAVIBACTER
SEPEDONICUS* (SPIECKERMANN&KOTTHOFF 1914) NOUIOUI *ET AL.* 2018¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë masat për të çrrënjësuar dhe parandaluar përhapjen e *Clavibacter sepedonicus* (Spieckermann&Kotthoff 1914) Nouiou et al. 2018, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si shkaktari i kalbëzimit unazor të patates.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e përcaktuar në nenin 2, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, dhe në nenin 2, të urdhrit nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores “Për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim.

Ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dëmtues i specifikuar” është kalbëzimi unazor i patates *Clavibacter sepedonicus* (Spieckermann & Kotthoff 1914) Nouiou et al. 2018;
2. “Bimë të specifikuara” është bima e *Solanum tuberosum* L., të ndryshme nga farat;
3. “Bimë të specifikuara të pa kultivuar” është bima e specifikuar që shfaqet në vendet e prodhimit pa u mbjellë;
4. “Zhardhokët e destinuar për t’u mbjellë në vendin e tyre të prodhimit” janë zhardhokët e prodhuar në një vend të caktuar prodhimi, të cilët synohen të qëndrojnë përgjithmonë në atë vend dhe nuk synohen të certifikohen;
5. “Zonë shumë e infektuar” është një zonë në vend, ku numri i vendeve të shpërthimit të identifikuar gjatë vrojtimeve vjetore gjatë një periudhe të vazhdueshme prej më shumë se 10 vjetësh ka treguar se dëmtuesi i specifikuar është i pranishëm në shumë vende dhe ku nuk mund të përjashtohet që ky dëmtues, është gjithashtu i pranishëm në vendet e prodhimit të cilat nuk janë nën mbikëqyrje zyrtare.

¹ Ky udhëzim përaftron plotësisht Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2022/1194, të datës 11 korrik 2022, e cila përcakton masa për qëllimin e çrrënjësjes dhe parandalimin e përhapjes së *Clavibacter sepedonicus* (Spieckermann & Kotthoff 1914) Nouiou et al. 2018, si shkaktar i kalbëzimit unazor të patates.

Neni 3

Vrojtime vjetore

1. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), kryen vrojtime vjetore për praninë e dëmtuesit të specifikuar në bimët e specifikuara në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) në zhardhokët e ndryshëm nga ato për mbjellje, vrojtimet duhet të përfshijnë:

i. marrjen e mostrave nga parcelat e zhardhokëve në magazinë ose nga kultura në rritje, sa më vonë që të jetë e mundur ndërmjet tharjes së ngarkesave dhe korrijës;

ii. inspektimi vizual i kulturës në rritje, ku është e mundur të identifikohen vizualisht simptomat e dëmtuesit të specifikuar, dhe inspektimi vizual i zhardhokëve të prerë, në rastet kur ky inspektim është i përshtatshëm për të zbuluar simptomat e dëmtuesit të specifikuar;

b) në zhardhokët për mbjellje, të ndryshëm nga ato që synohen të mbillen në vendin e tyre të prodhimit, vrojtimet duhet të përfshijnë në mënyrë sistematike inspektimin vizual të kulturave në rritje dhe të pjesëve në magazinë, marrjen e mostrave në magazinë ose marrjen e mostrave nga kulturat në rritje sa më vonë që të jetë e mundur ndërmjet tharjes së masës vegetative dhe vjeljes;

c) në zhardhokët që synohen të mbillen në vendin e tyre të prodhimit, studimet do të kryhen në bazë të riskut të identifikuar në lidhje me praninë e dëmtuesit të specifikuar dhe do të përfshijnë:

i. marrjen e mostrave nga parcelat e zhardhokëve në magazinë ose nga kultura në rritje, sa më vonë që të jetë e mundur ndërmjet tharjes së masës vegetative dhe vjeljes;

ii. inspektimi vizual i kulturës në rritje, ku është e mundur të identifikohen vizualisht simptomat e dëmtuesit të specifikuar, dhe inspektimi vizual i zhardhokëve të prerë në rastet kur ky inspektim është i përshtatshëm për të zbuluar simptomat e dëmtuesit të specifikuar;

ç) për sa i përket bimëve të specifikuara, përveç zhardhokëve, vrojtimet dhe marrja e mostrave të bimëve do të kryhen në përputhje me metodat e duhura për të identifikuar dëmtuesin e specifikuar në ato bimë.

2. Numri, origjina dhe koha e grumbullimit të mostrave duhet të bazohen në parime të shëndosha shkencore dhe statistikore, dhe në biologjinë e dëmtuesit të specifikuar, duke marrë parasysh sistemet e veçanta të prodhimit të patates në vendin tonë.

3. AKVMB-ja i raporton strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve (SPMB-së), brenda datës 30 prill të çdo viti, rezultatet e vrojtimeve vjetore të kryera gjatë vitit kalendarik paraardhës. Raportimi i rezultateve të këtyre vrojtimeve bëhet në përputhje me formatin e përcaktuar në aneksin II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 4

Masat në rast dyshimi për praninë e dëmtuesit të specifikuar

1. AKVMB-ja garanton që mostrat e marra për qëllime të vrojtimeve vjetore i nënshtrohen testeve të zbulimit, të përmendura në pikën 2.1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV).

2. Në pritje të rezultateve të testeve të zbulimit, AKVMB-ja:

a) ndalon lëvizjen e bimëve të specifikuara nga të gjitha kulturat, lotet ose ngarkesat nga të cilat janë marrë mostrat, përveç bimëve të specifikuara nën kontrollin e tij, për të cilat është vërtetuar se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesve të specifikuar;

b) gjurmon origjinën e pranisë së dyshuar;

c) kryen kontrollin zyrtar të lëvizjes së çdo bime të specifikuar, përveç atyre të përmendura në shkronjën “a”, të prodhuara në vendin e prodhimit nga i cili janë marrë mostrat e përmendura në shkronjën “a”.

3. Në pritje të rezultateve të testeve të zbulimit, ISUV-ja në bashkëpunim me AKVMB-në do të garantojnë që të gjithë elementet e mëposhtëm të ruhen dhe arshivohen në mënyrë të përshtatshme:

a) të gjithë zhardhokët e mbetur të mostrave dhe, aty ku është e mundur, të gjitha bimët e mbetura të mostruar;

b) ekstraktet e mbetura të bimës së specifikuar, ekstraktet e ADN-së dhe materialet shtesë të përgatitura për testim;

c) kulturën e pastër kur është e përshtatshme;

ç) të gjithë dokumentacionin përkatës.

4. Kur dyshimi për praninë e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në përputhje me pikën 1.1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, AKVMB-ja garanton që testet e përmendura në aneksin I bashkëlidhur këtij udhëzimi të kryhen nga ISUV-ja në mostrat e marra për qëllimin e vrojtimeve për të konfirmuar ose refuzuar praninë e dëmtuesit të specifikuar.

Neni 5

Masat në rast të konfirmimit të pranisë së dëmtuesit të specifikuar

1. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në përputhje me pikat 1.2 ose 1.3, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, do të zbatohen pikat 2 deri në 9 të këtij neni.

2. AKVMB-ja krijon pa vonesë një zonë të shënuar, duke marrë parasysh elementet e renditura në pikën 1, të aneksit III bashkëlidhur këtij udhëzimi, për përcaktimin e përhapjes së mundshme të dëmtuesit të specifikuar.

3. Zona e shënuar përmban një zonë të infektuar dhe kur është e nevojshme për të adresuar riskun fitosanitar, një zonë sigurie rreth zonës së infektuar.

4. Zona e infektuar, përmban të gjitha kriteret e mëposhtme:

a) bimët e specifikuara, ngarkesat dhe/ose lotet, automjetet, anijet, magazinat ose njësitë e tyre nga të cilat është marrë një mostër e specifikuar bimore e infektuar, çdo objekt tjetër, duke përfshirë materialin e ambalazhimit dhe makinerinë e përdorur për prodhimin, transportin dhe ruajtjen e këtyre bimëve të specifikuara dhe, sipas rastit, vendin(et) e prodhimit ose vendndodhjen e prodhimit ku këto bimë të specifikuara, janë rritur ose vjelur;

b) të gjitha llojet e kriteret e renditura në shkronjën “a”, të përcaktuara se janë potencialisht të infektuar nga dëmtuesi i specifikuar, duke marrë parasysh elementet e renditura në pikën 2, të aneksit III bashkëlidhur këtij udhëzimi, nëpërmjet kontakteve para ose pas vjeljes, ose nëpërmjet fazave të njëkohshme të prodhimit, me bimë të specifikuara të infektuara.

5. AKVMB-ja përcakton:

a) kriteret e renditura në shkronjën “a”, të pikës 4, si të infektuar;

b) kriteret e listuara në shkronjën “b”, të pikës 4, si potencialisht të infektuar.

6. Zhardhokët me origjinë nga një zonë e shënuar nuk duhet të zhvendosen nga ajo zonë e shënuar, përveç rastit kur vërtetohet se ata janë të pastër nga dëmtuesi i specifikuar në bazë të testeve të përmendura në aneksin I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. AKVMB-së ose operatorëve profesionistë nuk u kërkohet të raportojnë një njoftim për shpërthim, kur dëmtuesi i specifikuar ndodhet në një zonë shumë të infektuar, të listuar në aneksin IV, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

8. Kur një drejtori rajonale e veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve (DRVMB) pranë AKVMB-së ka konfirmuar zyrtarisht praninë e këtij dëmtuesi, DRVMB-ja që kufizohet, do të përcaktojë shtrirjen e infeksionit potencialisht dhe do të krijojë një zonë të shënuar, në përputhje me pikat 2, 3 dhe 4.

9. ISUV-ja garanton që të gjitha elementet e mëposhtme të ruhen dhe arshivohen në mënyrë të përshtatshme:

- a) materialin e specifikuar në pikë 3, të nenit 4, deri në përfundimin e të gjitha testeve;
- b) materialin që lidhet me testin e dytë të zbulimit dhe me testet e identifikimit kur është e përshtatshme, deri në përfundimin e të gjitha testeve;
- c) nëse është e aplikueshme, kultura e pastër e dëmtuesit të specifikuar, deri të paktën një muaj pas procedurës së njoftimit zyrtar.

Neni 6

Masat për çrrënjosjen e dëmtuesve të specifikuar

1. Bimët e specifikuara, të përcaktuara si të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 5, nuk do të mbillen. AKVMB-ja garanton që bimët e specifikuara të infektuara të shkatërrohen ose të asgjësohen në një mënyrë tjetër, në përputhje me pikën 1, të aneksit V bashkëlidhur këtij udhëzimi, me kusht që të vërtetohet se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar.

Kur bimët e specifikuara janë mbjellë përpara se të përcaktohen si të infektuara, materiali i mbjellë do të shkatërrohet ose asgjësohet menjëherë në përputhje me pikën 1, të aneksit V bashkëlidhur këtij udhëzimi. Vendndodhjet e prodhimit ku janë mbjellë bimët e specifikuara të infektuara duhet të caktohen si të infektuara.

2. Bimët e specifikuara të përcaktuara si potencialisht të infektuara, sipas shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 5, nuk do të mbillen dhe pa paragjykuar rezultatin e testeve të përmendura në nenin 7 për stoqet e lidhura klonisht, do të jenë nën mbikëqyrjen zyrtare, të vihet në përdorim ose asgjësim të duhur siç specifikohet në pikën 2, të aneksit V bashkëlidhur këtij udhëzimi, në mënyrë të tillë që të përcaktohet se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar.

Kur bimët e specifikuara janë mbjellë përpara se të përcaktohen si potencialisht të infektuara, materiali i mbjellë do të shkatërrohet menjëherë ose do të vihet në përdorimin, ose në asgjësimin e duhur, siç specifikohet në pikën 2, të aneksit V bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Vendndodhjet e prodhimit ku bimët e specifikuara si potencialisht të infektuara janë mbjellë, do të caktohen si potencialisht të infektuara.

3. Çdo makineri, mjet, anije, magazinë ose njësi e tyre dhe çdo objekt tjetër, duke përfshirë materialin e ambalazhimit, të përcaktuar si të infektuar ose si potencialisht të infektuar, në përputhje me pikën 5, të nenit 5 ose do të shkatërrohet, ose pastrohet dhe dezinfektohet duke përdorur metodat e specifikuara në pikën 3, të aneksit V bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Përveç masave të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3, në zonat e shënuara zbatohen masat e përcaktuara në pikën 4, të aneksit V bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 7

Masat specifike të testimit për zbardhokët për mbjellje

1. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar është konfirmuar nga ISUV-ja në një vendndodhje prodhimi të zbardhokëve për mbjellje, AKVMB-ja duhet të garantojnë që testet e përmendura në aneksin I bashkëlidhur këtij udhëzimi të kryhen në linjat e lidhura klonisht me lotet e infektuara të zbardhokëve ose kur konstatohet mungesa e linjave të lidhura me klonim, në zbardhokët ose lotet, zbardhokët që kanë qenë në kontakt të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë me lotet e infektuara të zbardhokëve.

2. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar është konfirmuar në vendndodhjen e prodhimit të zbardhokëve për mbjellje në një skemë certifikimi, testet e përmendura në aneksin I, bashkëlidhur

këtij udhëzimi, do të kryhen ose në secilën bimë të përzgjedhjes klonale fillestare, ose në mostrat përfaqësuese të farës bazë të patates.

Neni 8

Masat e përkohshme, në lidhje me lëvizjet e zhardhokëve të bimëve të specifikuar me origjinë nga një zonë shumë e infektuar

1. Zhardhokët e bimëve të specifikuar, përveç atyre për mbjellje, me origjinë nga një zonë shumë e infektuar e renditur në aneksin IV, bashkëlidhur këtij udhëzimi, mund të zhvendosen nga ajo zonë në zona të tjera të vendit, vetëm nëse plotësojnë dy kushtet e mëposhtme:

a) shoqërohen nga një pasaportë bimore ose certifikatë fitosanitare e brendshme;

b) kanë origjinën nga një vend prodhimi i regjistruar dhe i mbikëqyrur nga AKVMB-ja dhe i njohur zyrtarisht si i pastër nga dëmtuesit e specifikuar; ose janë gjetur të pastra nga dëmtuesi i specifikuar në bazë të mostrimit dhe testimit të kryer në përputhje me aneksin I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Çdo pesë vjet, AKBVM-ja dhe ISUV-ja në bashkëpunim me SPMB-në do të hartojnë një raport, në lidhje me evolucionin e zonave të tyre përkatëse shumë të infektuara.

Neni 9

Dispozitat përfundimtare dhe hyrja në fuqi

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 janar 2025.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

ANEKSI I

Skema për testet që do të kryhen sipas neneve 3, 4, 5, 7 dhe 8

1. PARIME TË PËRGJITHSHME MBI PRANINË E DËMTUESIT TË SPECIFIKUAR

1.1 Prania e dëmtuesit të specifikuar dyshohet kur merret një rezultat pozitiv në testin e parë të zbulimit të kryer në bimën e specifikuar.

Për materialin bimor simptomatik, testi i parë i zbulimit mund të jetë një izolim selektiv.

1.2 Prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në mostrat simptomatike të bimëve të specifikuara në rastet e mëposhtme:

a) kur testi i parë i zbulimit është një izolim selektiv që rezulton në koloni me morfologji tipike: rezultatet pozitive merren në dy teste identifikimi;

b) kur testi i parë i zbulimit është një test tjetër përveç një izolimi selektiv:

i. rezultatet pozitive merren në dy teste identifikimi pasi mostrimi i është nënshtruar izolimit selektiv;

ii. rezultatet pozitive janë marrë në një test të dytë zbulimi, përveç një izolimi selektiv.

1.3 Prania e dëmtuesit të specifikuar konfirmohet në mostrat asimptomatike të bimëve të specifikuara në rastet e mëposhtme:

a) kur një rezultat pozitiv është marrë në testin e dytë të zbulimit me kusht që testi i parë ose i dytë i zbulimit të jetë një test molekular (i bazuar në ADN) (TaqMan[®] Real-Time PCR në kohë reale ose PCR konvencionale);

b) për mostrat e marra në një rajon ose në një zonë të një rajoni, ku dëmtuesi i specifikuar nuk dihet se është hasur dhe për mostrat që kanë origjinën nga një rajon tjetër: kur një rezultat pozitiv është marrë në testin e dytë të zbulimit, në përputhje me shkronjën “a” dhe rezultatet pozitive merren në dy teste identifikimi të kryera pasi mostra i është nënshtruar izolimit selektiv.

2. TESTET

2.1 Testet e zbulimit

Testet e zbulimit duhet të jenë të tilla që të zbulojnë vazhdimisht të paktën 10^4 qeliza/ml pelet të risuspenduar.

Testi i dytë i zbulimit duhet të bazohet në parime të ndryshme biologjike ose në rajone të ndryshme nukleotide se testi i parë i zbulimit.

Testet e zbulimit janë si më poshtë:

a) testet e imunofluoreshencës, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

b) testi FISH (van Beuningen *et al.* (1995) ¹), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

c) izolimi, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit. Një nga dy opsionet e mëposhtme do të kryhet:

i. izolimi i drejtpërdrejtë në terren rritës gjysmëselektiv (ose joselektiv), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

ii. pas pasurimit nëpërmjet analizës biologjike (*bioassay*), izolimi siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

ç) testi konvencional PCR duke përdorur *primer*-in e Pastrik (2000) ², siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

d) TaqMan[®] testet real-time PCR duke përdorur *primer*-in dhe *probe*-in të:

i. Schaad *et al.* (1999) ³, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

ii Vreeburg *et al.* (2018) ⁴ (i ashtuquajtur i test NYtor), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

iii. Gudmestad *et al.* (2009), siç është përshtatur nga Vreeburg *et al.* (2018) ⁴, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;

iv. Massart *et al.* (2014) ⁵, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

2.2 Testet e identifikimit

¹ Van Beuningen, A.R., Derks, H., Janse, J.D. (1995). Zbulimi dhe identifikimi i *Clavibacter michiganensis subsp. sepedonicus* me vëmendje të veçantë ndaj hibridizimit fluoreshent *in situ* (FISH), duke përdorur një *probe oligonukleotide* të synuar me 16S rRNA. *Züchtungs Forschung* 1, f. 266–269.

² Pastrik, K.H. (2000). Zbulimi i *Clavibacter michiganensis subsp. sepedonicus* në zhardhokët e patates me multipleks PCR me bashkim të ADN-së së bujtësit. *European Journal of Plant Pathology*, 106, f. 155–165.

³ Schaad, W., Berthier-Schaad, Y., Sechler, A., Knorr, D. (1999). Zbulimi i *Clavibacter michiganensis subsp. sepedonicus* në zhardhokët e patates nga BIOPCR dhe një sistem i automatizuar i zbulimit të fluoreshencës në kohë reale. *Sëmundja e bimëve* 83, f. 1095–1100.

⁴ Vreeburg, R., Zendman, A., Pol A., Verheij, E., Nas, M., Kooman-Gersmann, M. (2018). Validimi i katër TaqMan PCR në kohë reale për zbulimin e *Ralstonia solanacearum* dhe/ose *Ralstonia pseudosolanacearum* dhe/ose *Clavibacter michiganensis subsp. sepedonicus* në zhardhokët e patates, duke përdorur një qasje të regresionit statistikor. *Buletini EPPO* 48, f. 86–96.


⁵ Massart, S., Nagy, C., Jijakli, M.H. (2014). Zhvillimi i zbulimit të njëkohshëm të *Ralstonia solanacearum* *race 3* dhe *Clavibacter michiganensis subsp. sepedonicus* në zhardhokët e patates me anë të një analize të shumëfishtë PCR-je në kohë reale. *European Journal of Plant Pathology* 138, f. 29–37.

Testet e identifikimit janë si më poshtë:

- a) test imunofluorescence, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;
- b) testi konvencional PCR (Patrik (2000)), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;
- c) TaqMan[®] testet real-time PCR duke përdorur *primer*-in dhe *probe*-in të:
 - i. Schaad *et al.* (1999), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;
 - ii. Vreeburg *et al.* (2018) (i ashtuquajtur test NYtor), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;
 - iii. Gudmestad *et al.* (2009) siç është përshtatur nga Vreeburg *et al.* (2018), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;
 - iv. Massart *et al.* (2014), siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;
- ç) barkodimi i ADN-së, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit;
- d) MALDI-TOF MS (Zaluga *et al.* (2011))¹, siç përshkruhet në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

3. DIAGRAMI RRJEDHËS I PROCEDURAVE

Diagrami rrjedhës nr. 1: Procedura diagnostikuese për praninë e dëmtuesit të specifikuar në mostrat simptomatike të bimës së specifikuar




¹ Zaluga, J., Heylen, K., Van Hoorde, K., Hoste, B., Vaerenbergh, J., Maes, M., De Vos, P. (2011). Analiza e sekuencës GyrB dhe MALDI-TOF

MS si mjete identifikimi për *Clavibacter* patogjenë bimore. Mikrobiologjia sistematike dhe e aplikuar 34, 400-7. 10.1016/j.syapm.2011.05.001.

^a Izolimi mund të përdoret si testi i parë ose i dytë i zbulimit. Nëse dyshohet prania e dëmtuesit të specifikuar në mjedisin e rritjes, kolonitë duhet të pastrohen për të marrë kultura të pastra mbi të cilat do të kryhen dy teste identifikimi. Rezultatet pozitive në dy testet e identifikimit kërkohen për të konfirmuar praninë e dëmtuesit.

^b Testi i tretë i zbulimit do të bazohet në parime të ndryshme biologjike ose në rajone të ndryshme nukleotide.

Diagrami rrjedhës nr. 2: Procedura diagnostikuese për dëmtuesin e specifikuar në mostrat asimptomatike të bimës së specifikuar



^a Izolimi nuk duhet të përdoret.

^b Testi i tretë i zbulimit do të bazohet në parime të ndryshme biologjike ose në rajone të ndryshme nukleotide. Izolimi nuk duhet të përdoret.

^c Për mostrat e përmendura në shkronjën “b”, të pikës 1.3, konfirmimi i pranisë së specifikuar të dëmtuesve pas testit të dytë pozitiv të zbulimit kërkon izolimin e dëmtuesit të specifikuar nga mostra, i ndjekur nga dy teste identifikimi pozitive.

4. PËRGATITJA E MOSTRAVE

4.1 Mostrat nga zhardhokët asimptomatik

Mostra standarde duhet të përmbajë 200 zhardhokë për provë. Procedura e përshtatshme laboratorike për përpunimin e bërthamave përfaqësuese, për të marrë ekstraktin për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar, është përshkruar në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

4.2 Mostrat nga materiali bimor asimptomatik, përveç zhardhokëve

Zbulimi i infeksionit të fshehtë (latente) do të kryhet në mostrat e përbëra të segmenteve të kërcellit. Procedura mund të zbatohet për deri në 200 pjesë të kërcellit nga bimë të ndryshme në një mostër. Procedura e përshtatshme laboratorike për dezinfektimin dhe përpunimin e segmenteve të kërcellit për të marrë ekstraktin, për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar, është përshkruar në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

4.3 Mostrat nga bimët e specifikuara simptomatike

Seksionet e indeve duhet të hiqen në mënyrë aseptike nga unaza vaskulare në një zhardhok ose nga enët vaskulare në kërcellin e bimëve të specifikuara që shfaqin simptoma të tharjes. Procedura e përshtatshme laboratorike për përpunimin e këtyre indeve, për të marrë ekstraktin, për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar, është përshkruar me detaje të plota në standardet ndërkombëtare të diagnostikimit.

ANEKSI II

Formati i vrojtimit, referuar në pikën 3, të nenit 3

Formati për paraqitjen e rezultateve të vrojtimit të kalbëzimit unazor për vjeljen e patates, të vitit kalendarik paraardhës.

Kjo tabelë do të përdoret vetëm për rezultatet e anketës për patatet e vjelura në vend.

Kategoria	Zona e mbjelljes (ha)	Testimi laboratorik						Inspektimi vizual i zhardhokëve ⁽¹⁾			Inspektimet vizuale të kulture në rritje ⁽¹⁾			Informacioni tjetër
		Numri i mostrave	Numri i loteve	Madhësia e lotet (në t ose ha)	Periudha e mostrimit	Jo pozitive		Numri i mostrave të inspektuara	Madhësia e mostrës	Nr. i mostrave pozitiv (2)	Numri e vizuale inspektimet	Nr. prej ha	Nr. i rezultateve pozitiv (2)	
						Mostrat	Lotet							
Zhardhokët e certifikuar për mbjelljen														
Zhardhokët e tjerë për mbjellje (specifikoni)														
Mallra dhe patatet e përpunuara														
Zhardhokët e tjerë (specifiko)														

⁽¹⁾ Kuptohet si ekzaminim makroskopik i zhardhokëve ose kulturave.

⁽²⁾ U gjenden simptoma, u mor një mostër dhe testimi laboratorik konfirmoi praninë e dëmtuesit të specifikuar.

ANEKSI III

Elementet për përcaktimin e përhapjes së mundshme të dëmtuesit të specifikuar dhe për përcaktimin e kriterëve si potencialisht të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar, siç përmendet në piken 2, të nenit 5 dhe në shkronjën “b”, të pikës 4, të nenit 5

1. Elementet që duhen marrë parasysh në përcaktimin e përhapjes potenciale të dëmtuesit të specifikuar, siç përmendet në pikën 2, të nenit 5, janë si më poshtë:

- a) afërsia e vendeve të tjera të prodhimit ku rriten bimë të specifikuara ose bimë të tjera bujtëse;
- b) prodhimin dhe përdorimin e përbashkët të stoqeve të farës së patates.

2. Elementet që duhet të merren parasysh për përcaktimin e një pjese si potencialisht të infektuar nga dëmtuesi i specifikuar, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 4, të nenit 5, janë si më poshtë:

a) bimët e specifikuara të rritura në një vend prodhimi të përcaktuar si të infektuar, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 5;

b) vendi(et) e prodhimit me ndonjë lidhje prodhimi me bimët e specifikuara të përcaktuara si të infektuara, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 5, duke përfshirë ato që ndajnë pajisjet dhe mjediset e prodhimit drejtpërdrejt ose nëpërmjet një kontraktori të përbashkët;

c) bimët e specifikuara të prodhuara në vendet e prodhimit të përmendura në shkronjën “b” ose të pranishme në këto vende prodhimi gjatë periudhës kur bimët e specifikuara janë përcaktuar si të infektuara, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 5, ishin të pranishëm në vendin e prodhimit të përmendur në shkronjën “a”;

ç) ambientet që trajtojnë bimët e specifikuara nga vendet e prodhimit të përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c”;

d) çdo makineri, mjet, anije, magazinë ose njësi të tyre dhe çdo objekt tjetër, duke përfshirë materialin e ambalazhit, që mund të ketë rënë në kontakt me bimët e specifikuara të përcaktuara si të infektuara, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 5;

e) çdo bimë të specifikuara të ruajtur në, ose në kontakt me, ndonjë nga strukturat ose objektet e listuar në shkronjën “d”, përpara pastrimit dhe dezinfektimit të strukturave dhe objekteve të tilla;

ë) si rezultat i testimit sipas nenit 7, bimë të specifikuara me një lidhje klonale me bimët e specifikuara të përcaktuara si të infektuara, sipas shkronjës “a”, të nenit 5, dhe për të cilat, megjithëse mund të kenë rezultuar negativë për dëmtuesin e specifikuar, duket se infeksioni është i mundshëm nëpërmjet një lidhjeje klonale. Testimi i varietetit mund të ndërmerret për të verifikuar identitetin e zhardhokëve ose bimëve të infektuara dhe të lidhura me klonim;

f) vendi(et) e prodhimit të bimëve të specifikuara të përmendura në shkronjën “ë”.

ANEKSI IV

Lista e zonave shumë të infektuara, siç përmendet në nenin 8

ANEKSI V

Masat e çrrënjësjes, të përcaktuara në nenin 6

1. Masat e çrrënjësjes të përmendura në pikën 1, të nenit 6, do të jenë një ose më shumë, nga sa vijon:

a) përdorimi si ushqim për kafshët pas trajtimit termik, në mënyrë që të mos ketë risk për mbijetesën e dëmtuesit të specifikuar;

b) asgjësimi në një vend të dedikuar të depozitimit të mbetjeve, të miratuar zyrtarisht, në të cilin nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar në mjedis, p.sh. përmes kullimit në tokë bujqësore;

c) djegia;

ç) përpunimi industrial nëpërmjet dorëzimit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në një fabrikë përpunimi me objekte të miratuara zyrtarisht të depozitimit të mbetjeve, për të cilat është vërtetuar se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesve të specifikuar dhe me një sistem pastrimi, dhe dezinfektimi të paktën automjetet në nisë;

d) masa të tjera, me kusht që të jetë vërtetuar se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar; masat e tilla dhe arsyetimi i tyre duhet t'i njoftohen SPMB-së në ministri.

Çdo mbetje e mbetur e lidhur dhe që rrjedh, nga sa më sipër, do të asgjësohet me metoda të miratuara zyrtarisht në përputhje me aneksin VI.

2. Përdorimi ose asgjësimi i duhur i bimëve të specifikuara, të përcaktuara si të mundshme të infektuara, në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 5, të nenit 5, do të kryhet nën kontrollin e AKVMB-së. AKVMB-ja do të miratojë përdorimet e mëposhtme dhe depozitimin e mbetjeve përkatëse, të këtyre bimëve të specifikuara:

a) përdoret si zhardhok i destinuar për konsum, të pakeluar gati për shpërndarje direkte dhe pa riambalazhim, në një vend me objektet e përshtatshme të depozitimit të mbetjeve. Zhardhokët për mbjellje mund të trajtohen vetëm në të njëjtin vend, nëse kjo bëhet veçmas ose pas pastrimit dhe dezinfektimit; ose

b) të përdoren si zhardhokë të destinuar për përpunim industrial dhe të destinuara për dërgim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në një fabrikë përpunimi me pajisje të përshtatshme për depozitimin e mbetjeve dhe një sistem pastrimi, dhe dezinfektimi të të paktën automjeteve që nisen; ose

c) ndonjë përdorim ose asgjësim tjetër, me kusht që të vërtetohet se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar dhe që i nënshtrohet miratimit nga AKVMB-ja.

3. Metodatat e përshtatshme për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve, të përmendura në pikën 3, të nenit 6, do të jenë ato për të cilat është vërtetuar se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar dhe do të përdoren nën mbikëqyrjen e AKVMB-së.

4. Seria e masave që do të zbatohen nga AKVMB-ja brenda zonës së shënuar, e krijuar në përputhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 5 dhe të referuara në pikën 4, të nenit 6, do të përfshijë masat e përcaktuara në pikat 4.1 dhe 4.2:

4.1 Masat që duhen marrë në vendet e prodhimit të përcaktuara si të infektuara, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 5:

4.1.1 Në një vendndodhje prodhimi të përcaktuar si të infektuar, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 5, do të merren të gjitha masat e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 ose të gjitha masat e përcaktuara në pikat 4 dhe 5, si vijon:

1. Gjatë tre viteve të para të rritjes pas vitit të përcaktimit të infeksionit, eliminimit të bimëve të specifikuara të pakultivuara dhe ndalimit të mbjelljes së bimëve të specifikuara, duke përfshirë farat, ose të kulturave për të cilat ekziston një risk i identifikuar i përhapjes së dëmtuesve të specifikuar;

2. Nga viti i katërt pas vitit të përcaktimit të infeksionit, pas përmbushjes së kushteve të pikës 1 dhe me kusht që vendndodhja e prodhimit të jetë gjetur e pastër nga bimët e specifikuara të pambjella gjatë

kontrolleve zyrtare, për të paktën dy vite radhazi rritje para mbjelljes, do të lejohet vetëm prodhimi i zhardhokëve të ndryshëm nga ato të destinuara për mbjellje dhe zhardhokët e vjelur do të testohen në përputhje me aneksin I;

3. Pas prodhimit të parë të zhardhokëve, siç përmendet në pikën 2 dhe pas një cikli të përshtatshëm qarkullimi prej të paktën dy vitesh nëse do të rriten zhardhokët për mbjellje, bimët e specifikuar mund të mbillen për prodhimin e secilit prej zhardhokëve për mbjellje ose prodhim tjetër zhardhoku, dhe do të kryhet një vrojtim siç parashikohet në nenin 3; ose

4. Gjatë katër viteve të para të rritjes pas vitit të përcaktimit të infeksionit, eliminimi i bimëve të specifikuar të pakultivuara dhe mirëmbajtja e vendndodhjes së prodhimit në ugar të pa mbjellur ose në kullota të përherëshme me prerje të shpeshta afër ose kullotje intensive;

5. Nga viti i pestë pas vitit të përcaktimit të infeksionit dhe me kusht që të plotësohet pika 1 dhe se vendndodhja e prodhimit është gjetur e pastër nga bimët e specifikuar të pakultivuara gjatë kontrolleve zyrtare për të paktën dy vite radhazi të rritjes përpara mbjelljes, prodhimi i zhardhokët për mbjellje dhe zhardhokët e tjerë do të lejohen, dhe zhardhokët e vjelur do të testohen në përputhje me aneksin I.

4.1.2 Në të gjitha vendndodhjet e tjera të prodhimit të vendit të infektuar të prodhimit dhe me kusht që AKVMB-ja të kenë vërtetuar se risku i bimëve të specifikuar të pakultivuara dhe i bimëve bujtëse të egra *solanaceous* të dëmtuesit të specifikuar sipas rastit është eliminuar, do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

1. Në vitin e rritjes që pason atë të përcaktimit të infeksionit ose nuk do të mbillet asnjë bimë e specifikuar, duke përfshirë farat, ose zhardhokët e certifikuar për mbjellje mund të mbillen për prodhimin e zhardhokëve të ndryshëm nga ato vetëm për mbjellje;

2. Në vitin e dytë të rritjes pas atij të përcaktimit të infeksionit, vetëm zhardhokët e certifikuar për mbjellje ose zhardhokët për mbjellje të testuar zyrtarisht për mungesën e dëmtuesit të specifikuar dhe të rritur nën kontrollin zyrtar në vendet e prodhimit të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 4 do të mbillet për prodhimin e zhardhokëve për mbjellje ose të zhardhokëve të tjerë;

3. Për të paktën vitin e tretë të rritjes pas atij të përcaktimit të infeksionit, vetëm zhardhokët e certifikuar për mbjellje ose zhardhokët për mbjellje të rritura nën kontrollin zyrtar nga zhardhokët e certifikuar për mbjellje do të mbillen për prodhimin e zhardhokëve për mbjellje ose zhardhokëve të tjerë;

4. Në secilin nga vitet e rritjes, të përmendura në pikat 1, 2 dhe 3, do të merren masa për të eliminuar bimët e specifikuar të pakultivuara nëse janë të pranishme dhe në çdo vendndodhje prodhimi të bimëve të specifikuar, bimët e specifikuar të vjelura do të testohen, siç përmendet në aneksin I.

4.1.3 Menjëherë pas përcaktimit të infeksionit, në përputhje me pikën 5, të nenit 5 dhe pas vitit të parë të rritjes pasuese, të gjitha makineritë dhe objektet e magazinimit në vendin e prodhimit dhe të përfshira në prodhimin e bimëve të specifikuar duhet të pastrohen dhe dezinfektohen sipas rastit duke përdorur metoda të përshtatshme, siç përcaktohet në pikën 3.

4.1.4 Në një njësi të prodhimit bimor të mbrojtur të përcaktuar si të infektuar, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 5, ku zëvendësimi i plotë i terrenit të rritjes është i mundur:

1. Asnjë bimë e specifikuar, duke përfshirë farat, nuk do të mbillet nëse nuk plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) eliminimi i dëmtuesit të specifikuar,
- b) heqja e të gjithë materialit bimor bujtës,

c) ndryshimi i plotë i terrenit rritës dhe pastrimit, dhe dezinfektimit të njësisë së prodhimit dhe të gjitha pajisjeve,

ç) miratimin për prodhimin e bimëve të specifikuar nga AKVMB-ja;

2. Prodhimi i bimëve të specifikuar duhet të jetë nga zhardhokët e certifikuar për mbjellje, ose nga minizhardhokët ose mikrobimët që rrjedhin nga burime të testuara;

4.2 Brenda zonës së shënuar, përveç masave të detajuara në pikën 4.1, AKVMB-ja do të marri masat e mëposhtme:

1. Menjëherë pas përcaktimit të infeksionit, AKVMB-ja duhet të garantoj që të gjitha makineritë dhe objektet e magazinimit në këto vende prodhimi dhe të përfshira në prodhimin e bimëve të specifikuar të pastrohen dhe dezinfektohen, sipas rastit, dhe duke përdorur metoda të përshtatshme, siç specifikohet në pikën 3;

2. Menjëherë dhe për të paktën tre vjet të rritjes, pas përcaktimit të infeksionit, AKVMB-ja:

a) do të garantoj që të mbikëqyrin ambientet ku rriten, ruhen ose trajtohen zhardhokët, si dhe vendet e prodhimit të cilat operojnë makineri të bimëve të specifikuar sipas kontratës;

b) do të kërkojnë mbjelljen e vetëm zhardhokëve të certifikuar për mbjellje ose zhardhokëve për mbjellje të rritura nën kontrollin zyrtar, për të gjitha kulturat e bimëve të specifikuar brenda asaj zone, dhe testimin pas vjeljes së zhardhokëve për mbjelljen e kulturave të rritura në vendet e prodhimit të përcaktuara si potencialisht të infektuara, sipas shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 5;

c) do të kërkojnë trajtimin e veçantë të stoqeve të zhardhokëve të vjelur për mbjellje nga stoqet e zhardhokëve të tjerë në të gjitha vendet e prodhimit brenda zonës së shënuar ose një sistem pastrimi dhe dezinfektimi të kryhet ndërmjet trajtimit të rezervave të zhardhokëve;

ç) do të kryejnë vrojtimin vjetore, siç parashikohet në pikën 1, të nenit 3;

3. Do të krijojnë një program, sipas rastit, për zëvendësimin e të gjitha stoqeve të zhardhokëve për mbjellje gjatë një periudhe të përshtatshme kohore.

ANEKSI VI

Kërkesat për asgjësimin e mbeturinave të miratuara zyrtarisht, të përcaktuara në pikën 1, të aneksit V

Metodat e miratuara zyrtarisht të depozitimit të mbetjeve të përmendura në pikën 1, të aneksit V duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

1. Mbetjet e bimëve të specifikuar (përfshirë zhardhokët e refuzuar dhe lëkurën e zhardhokëve) dhe çdo mbetje tjetër e ngurtë, e lidhur me bimët e specifikuar (përfshirë dheun, gurët dhe mbeturinat e tjera), do të asgjësohen me një nga metodat e mëposhtme:

a) asgjësimi në një vend depozitimi të dedikuar të mbetjeve, të miratuar zyrtarisht, në të cilin nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar në mjedis, duke përfshirë rrjedhjen në tokën bujqësore;

b) djegia;

c) masa të tjera, me kusht që të jetë vërtetuar se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesve të specifikuar; masa të tilla do përcaktohen ose konfirmohen nga SPMB-ja.

Për qëllimet e shkronjës “a”, mbetjet do të transportohen drejtpërdrejt në kontejner nën kushte kontrolli të tilla që të mos ketë risk për humbjen e mbetjeve.

2. Përpara asgjësimit, mbetjet e lëngshëm që përmbajnë lëndë të ngurta pezulluar i nënshtrohen proceseve të filtrimit ose sistemimit për të hequr këto lëndë të ngurta, të cilat do të asgjësohen në përputhje me pikën 1.

Mbetjet e lëngshme më pas do të:

- a) nxehet në një temperaturë prej 60°C, për të paktën 30 minuta përpara se të hidhet; ose
- b) asgjësohet në një mënyrë tjetër që i nënshtrohet miratimit zyrtar dhe nën kontrollin zyrtar, në mënyrë që të mos ketë risk të identifikueshëm të kontaktit të mbetjeve me tokën bujqësore ose burimet ujore që mund të përdoren për ujitjen e tokës bujqësore.